



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 190/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të prezencës së personave të paautorizuar në Qendrën e Votimit (QV) 0701x/8R gjatë Ditës së Zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se rreth orës 12:00 në shkollën “Emin Duraku” 0701x/ 8R, afër 10-15 minuta ka qëndruar truproja e Xhabir Zharkut, Adem Kolshi duke vizituar Kryesuesit nëpër QV. Sipas pretenduesit të ankesës i njëjti nuk ka pasur bexh. Parashtruesi i ankesës thekson se hyrja e personave të paautorizuar në QV përbën shkelje të nenit 2 paragrafi 2 pika 8 e Rregullës Zgjedhore Nr.09/2009.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, në ora 15:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.190/2, PZAP-i, pranoi përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se: Adem Kolshi ka votuar në këtë QV ashtu siç e dëshmon në dokumentin ku ai voton, dokument të cilën subjekti politik PDK ia ka bashkangjitur përgjigjes në ankesë.

Po ashtu PZAP-i më datë 19.06.2012 nëpërmjet postës elektronike e njoftoi Lulzim Krasniqin, Menaxherin e Qendrës së Votimit 0701x, për ankesën që është bërë dhe ka

kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës nëpërmjet postës elektronike deri më datë 19.06.2012 ora 15:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen nëpërmjet postës elektronike në të cilën theksohet se në Qendrën e Votimit 0701x procesi zgjedhor është zhvilluar normalisht, nuk është vërejtur asnjë parregullsi, kurse për rastin e cekur në ankesë Menaxheri i Qendrës së Votimit 0701x Lulzim Krasniqi potencoi se nuk është e vërtetë sepse ai vetëm ka kryer procedurën e votimit dhe ka dal nga Qendra e Votimit, pasi që i është caktuar votimi në këtë qendër, gjë që rregullisht ka votuar në Doganaj përkatësisht në Kaçanik të vjetër ku shumë qytetarëve iu është ndërruar QV-ja dhe këtë e ka konfirmuar edhe KKZ-ja.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar, nga subjekti politik LVV, pretendohet se truproja e ish Kryetarit të Komunës së Kaçanikut Xhabir Zharkut, Adem Kolshi ka vizituar kryesuesit e VV në QV 0701x/08R, në shkollën fillore "Emin Duraku" i cili nuk ka poseduar bexh.

PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase fotografia e bashkangjitur që gjendet në shkresat e lëndës nuk dëshmon pretendimet e theksuara në ankesë ngase nuk mund të identifikohet objekti i QV-së për të cilin pretendohet se truproja e ish kryetarit të Kaçanikut i ka vizituar KVV në QV e sipërhënuar.

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pala ankuese pretendimet e theksuara në ankesë nuk i ka mbështetur në argumente, për më tepër në deklaratën e Menaxherit të QV0701x është theksuar se personi në fjalë vetëm ka kryer procedurën e votimit, pasi që shumë qytetarëve tjerë iu është ndërruar QV-ja, që është e konfirmuar dhe nga KKZ-ja. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë dhe i pa argumentuar, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 190/2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**

